



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SHTIMES



E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I KONSULTIMIT PUBLIK PËR NDËRTIMIN E SHESHIT DHE PARKINGUT
NËNTOKSOR NË SHTIME

Konsultimi publik është mbajtur më: 13.08.2025 (e mërkurë) në ora 14:00h. në sallën e Kuvendit.

Në Konsultim kanë marrë pjesë: Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi z. Grejtalb Emini, Udhëheqësi për Kadastër z.Sami Januzi, Zyrtari i Lartë për Çështje Pronësore z.Shqiprim Hyseni , Zyrtarja për Informim Vlora Hyseni dhe Zyrtarja për Çështje të Kuvendit (njëkohësisht procesmbajtëse) znj.Sadbere Halili. Diskutimin e hapi, Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi z. Grejtalb Emini.

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Përshëndetje, të gjithë e dimë që Kuvendi ka marrë një vendim për shpronësim të objektit para Komunës. Siç e dimë të gjithë duhet të mbahet konsultimi publik. Janë të indentifikuara 47 njësi banesore dhe afariste. 1 shtatori mendojë që duhet të jetë data e fundit për fillimin e procedurave. Kemi pasur telashe pak por zyrtarët kanë qenë të gatshëm për me i zgjidhë.

Qytetari 1: Është një listë për kfadrat, mirëpo kjo kfadatur nuk është te rasti jonë, këtu po shkruan mirëpo kur e kemi ble ka qenë më shumë.

Udhëheqësi për Kadastër, z.Sami Januzi: Në bazë të procedurave ky projekt i ka pas veq sipërfaqësisht metrat, mirëpo kur është ndërtuar ka pas dallim mes gjendjes faktike dhe asaj reale. Mundet me pas ndryshime por me procedurat tjera mirremi ne.

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Për me ju ik këtyre bëhet elaborati, për të i anashkaluar këto dallime. Keni me pas një njoftim kur ka me ardhë kompania speciale për këtë.

Qytetari 2: Të njejtin problem e kam edhe unë.

Udhëheqësi për Kadastër, z.Sami Januzi: Ai zgjerim është bërë me aktvendim të DPUKGJ-së. Pasi që të bëhet elaborati e shohim se a ju pranohet, elaborati e drejton këtë.

Qytetari 3: A ka filluar elaborati mu punu, edhe a ka me pas ndonjë kompani private dhe a kemi me pas mundësi me parë atë elaborat apo pasi të përfundojnë të gjitha procedurat?

Udhëheqësi për Kadastër, z.Sami Januzi: Ne si zyre nuk mundemi me e regjistruar pjesët e përbashkëta, si ju kanë detyru me i pagu është për keqardhje. Pjesët e përbashkëta nuk mund të regjistrohen në emra të veçantë, kjo është e pamundur edhe me herët e kemi diskutuar.

Qytetari 3: Po e kuptoj që pjesa e përbashkët nuk mundet me u bërë e veçantë. Por deshta me e ditë a kan me u trajtuar?

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Sa i përket elaboratit ne e kemi një marrëvshje me një kompani, kush dëshiron pas përfundimit të elaboratit mundet me ardhur me marrë një CD dhe me e pa elaboratin.

Qytetari 4: Kam bërë një padi në vitin 2007, unë qysh atëherë kam kërkuar kthimin e parave, mirëpo Gjykata na ka dërguar dhe na ka njoftur me vendim që këto para nuk mund të kthehen, por duhet të bëhet një aneksë kontratë për ato dy terasa që i kam rregulluar, këtë vendim na ka dhënë Gjykata.

Udhëheqësi për Kadastër, z.Sami Januzi: Në secilin aktgjykim që merrë Gjykata na obligon neve me regjistruar, e që në këtë rast nuk na obligon më shumë për me regjistruar. Ju problemin e keni me palën tjetër.

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Është obligativ për palën tjetër që është dashtë me nënshkruar aneksë kontratën, Komuna këtu nuk ka punë.

Qytetari 5: Kur mendoni me prishë, pëlqimin tim e keni?

Qytetari 6: Si bëhet vlerësimi, asnjëherë nuk e keni pastru, sa i përket terasave, ju e dini këtë, a bëhet vlerësimi para se mu prishë apo pas? Çka na jepni para apo pronë?

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Faleminderit për pyetjet, ne kemi ardhë me vendos. Nëse gjithçka shkon në rregull para 1 shtatorit keni me pas një njoftim. Nuk ka vlerësues që p.sh e vendos një banesë më pak se çmimi i tregut. Nuk kisha dashtë që me përmend asnjë shifër që me u mirrë për bazë. Nuk kemi nevojë me fol për objekte se kush e ka mbajtur pastër, sepse këtë e dimë. Janë disa emaila që kanë ardhur prej Policisë që ky objekt nuk mundet me u banu.

Qytetari 7: Nuk po e di që ka banesa këndeje, sepse të gjitha janë lokale?

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Në fletë poseduese shkruan. Si të kryhet elaborati kemi me fol me secilin veç e veç se a janë metrat e njejta apo jo.

Qytetari 8: Kur e sjellin vlerësimin para 1 shtatorit apo kur?

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Pas vlerësimit kemi me ju njoftuar që me qenë aty. Synimet tona janë që të bëhet vlerësimi para shpronësimit. Ti e merrë një pjesë të çmimit por mundesh edhe me ataku vendimin e Gjykatës.

Qytetari 9: Po më intereson çështja e shpronësimit të banesave, si do të rregullohet kjo çështje?

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Ne e kemi diskutuar edhe më herët dhe e dimë që përfitimi është me dhunë. Ne e kemi shfrytëzuar të drejtën që mos me ju njoftë e drejta e përfitimit.

Qytetari 9: Si do të veproni me ata që e fitojnë të drejtën në Gjykatë e që kanë qenë pronar?

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Çfarëdo vendimi që vjen nga Gjykata unë e përkrahë, mirëpo unë nuk e nëshkruaj nëse përfituesi është serb. Të gjitha lëndët i kanë dërguar në Gjykatë.

Qytetari 10: Sa do të zgjasë si process a parashihet një datë?

Drejtori për Planifikim Hapësinor, Kadastër dhe Gjeodezi, z.Grejtalb Emini: Për fat të mirë Kryetari e ka nënshkruar një memorandum që Ministaria e Ambientit me i pagu të gjitha këto. Brenda një viti nëse janë të gjitha procedurat në rregull përfundon kjo procedurë.

Procesmbajtëse:

Sadbere Halili

Halili



Drejtori i DPUKGJ-së

Grejtalb Emini













Grejtalb Emini






**LISTA E PJESËMARRËSVE NË KONSULTIMIN PUBLIK PËR
NDËRTIMIN E SHESHIT DHE PARKINGUT NËNTOKËSOR NË SHTIME**

Shtime, 13 gusht 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Imet Xheura		
2	Wahid Xher HUSEIN HASHA	AMBIENTALIST	Haba H.
3	Rafik Velin		
4	AFRIM KURTI		
5	IDRIZ ERINI		
6	Hazir Emini		
7	Amir Smaili		
8	NASER BAJRAMI		
9	BASHKIM BAJRAMI		Bajrami
10	BLETON REXHEPI		
11	Lulzim Mustafa		
12	Uehmet Ramadani		
13	Lymrije Ramadani		
14	Agim Azizi		
15	ENIS RAMADANI		
16	Lenolida Sabedini		
17	ISAK ZEGHANO		

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
18	Sefë Malizi		
19	Soli Begaj		
20	Sharif Schumari		
21	NEXHMEĐIN QERKINI		
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			